

Në bazë të nenit 13, pika 1, të Ligjit për lojërat e fatit Nr. 04/L-080, Drejtoria e Lotarisë së Kosovës në Prishtinë, Dardania – Kurrizi 15/17, me 25. 02. 2015 miratoi:

RREGULLAT E LOJËS SË FATIT KENO

I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këto Rregulla përcaktohen kushtet e përgjithshme për organizimin e lojës së fatit Keno.

Neni 2

Loja e fatit Keno (në vazhdim: loja Keno) është lojë me numra, ku tërheqja e numrave fitues bëhet me topëza dhe nëpërmjet mekanizmit elektronik.

Neni 3

Për obligimet ndaj pjesëmarrësve, organizatori përgjigjet me të gjitha mjetet, nëse janë plotësuar kushtet të përcaktuara me këto Rregulla.

Neni 4

Këto Rregulla janë bazë për arritjen e marrëveshjes për pjesëmarrjen në lojën Keno.

Marrëveshja, sipas paragrafit 1 të këtij neni, lidhet ndërmjet Lotarisë së Kosovës (në vazhdim: organizatori) në një rën anë dhe pjesëmarrësit (lojtarit) në anën tjetër, në bazë të pranimit të kushteve të përgjithshme të parapara me këto Rregulla, sipas shprehjes së lirë të lojtarit, me vetë aktin e pagesës së shumës së shkruar në vërtetimin e dhënë për lojën Keno.

Këto Rregulla (kushtet e përgjithshme) i obligojnë palët kontraktuese.

Neni 5

Pjesëmarrës në lojën Keno, konsiderohet personi i cili i pranon Rregullat e lojës, merr pjesë në lojë dhe si dëshmi posedon vërtetimin mbi pagesën (në vazhdim: vërtetimi), me kusht që përmbajtja e tij të jetë e regjistruar në CD para tërheqjes së numrave fitues, si dhe që shënimet kompjuterike në vërtetim dhe në CD të jenë identike.

Neni 6

Në bazë të nenit 13 të Ligji për lojërat e fatit, organizatori përcakton se Rregullat e lojës Keno detyrimisht duhet të përmbajnë:

1. emrin dhe selinë e organizuesit,
2. emrin, përshkrimin dhe kohëzgjatjen e lojës së fatit,
3. kushtet për pjesëmarrje në lojë,
4. vendin në të cilin organizohet loja, përkatësisht territorin ku bëhet shitja e tiketave,
5. çmimin – shumën e paguar për pjesëmarrje në lojë,
6. afatin e fundit të pagesës për pjesëmarrje në lojë,
7. shumën e përgjithshme të pagesës për një xhiro të luajtur,
8. lartësinë e fondit, dhe llojin e fitimeve,
9. përshkrimin e vërtetimit,
10. mënyrën, procedurën, mbikëqyrjen e tërheqjes dhe verifikimin e fitimeve,
11. mënyrën e publikimit të shumës së fondit fitues, llojet e fitimeve dhe rezultatet e lojës,
12. mënyrën dhe afatin e pagesës së fitimeve,
13. mënyrën e njohjes së pjesëmarrësve me Rregullat e lojës dhe
14. procedurën në rastin e revokimit të tërheqjes.

1. EMRI DHE SELIA E ORGANIZATORIT

Neni 7

Lotaria e Kosovës me seli në Prishtinë, Dardania-Kurrizi 15/17, është organizatore e lojës së fatit Keno.

2. EMRI, PËRSHKRIMI DHE KOHËZGJATJA E LOJËS

Neni 8

Emri i lojës është Keno. Loja Keno organizohet në mënyrë të përhershme, sipas xhirove. Në çdo xhiro të lojës Keno tërhiqen 20 numra nga grupi i numrave prej 1 deri 80. Pjesëmarrësit në lojë mund të përzgjedhin dhe të luajnë 1 deri 10 numra.

3. KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË LOJË

Neni 9

Dëshmi për pjesëmarrje në lojë është vërtetimi. Vërtetimi merr pjesë në atë xhiro për të cilën shënimet kompjuterike janë të regjistruara në CD.

Neni 10

Pagesat për pjesëmarrje në lojën Keno pranohen në çdo pikë ku organizohet loja Keno. Pranimi i pagesës përfundon me shtypjen e numrave të zgjedhur si dhe me dhënien e vërtetimit mbi pagesën.

Neni 11

Organizatori është i obliguar që shënimet e regjistruara në CD, t'i ruajë në shërbimin e PEM-it, në selinë e Lotarisë së Kosovës në Prishtinë në afatin e duhur kohor.

4. TERRITORI NË TË CILIN ORGANIZOHET LOJA KENO

Neni 12

Loja Keno organizohet në territorin e Republikës së Kosovës.

5. PAGESA PËR PJESËMARRJE NË LOJË

Neni 13

Pagesa për pjesëmarrje në lojën Keno është e përcaktuar sipas koeficienteve të paraparë me nenit 17.

6. AFATI I FUNDIT I PAGESËS PËR PJESËMARRJE NË LOJËN KENO

Neni 14

Pagesat për pjesëmarrje në lojën Keno pranohen më së voni deri 10 sekonda para tërheqjes së numrave. Për afatin e fundit të pranimit të pagesave, organizatori është i obliguar që t'i njoftojë palët (personat) e interesuar duke vendosur njoftime në çdo vendpajim.

7. SHUMA E PËRGJITHSHME E PAGESËS PËR NJË XHIRO

Neni 15

Pagesën e një xhiroje të lojës Keno e përbën shuma e pranuar e pagesës për atë xhiro, që përputhet me shënimet e ruajtura në arhivë.

8. LARTËSIA E FONDIT DHE LLOJET E FITIMEVE

Neni 16

Fondi i fitimit nuk mund të jetë më i madh se 82% e shumës së paguar, në afatin kohor prej 60 ditësh, me një tolerancë +/- 1%.

Neni 17

Shumat e fitimit për një tiketë caktohen sipas koeficientave në vijim, ku një koeficient është i barabartë me shumën prej 1.00 Euro (me fjalë: një Euro), dhe këtë si vijon:

1. Për një numër të përzgjedhur koeficienti është 3 (tre) kurse shuma e fituar është 3.00 Euro.

2. Për dy numra të përzgjedhur, koeficienti fitues është si vijon:

- Për dy numra të qëlluar koeficienti është 6 (gjashtë), kurse shuma e fituar është **6.00 Euro**,
- Për një numër të qëlluar koeficienti është 1 (një), kurse shuma e fituar është **1.00 Euro**.

3. Për tre numra të përzgjedhur, koeficienti fitues është si vijon:

- Për tre numra të qëlluar koeficienti është 12 (dymbëdhjetë), kurse shuma e fituar është **12.00 Euro**,
- Për dy numra të qëlluar koeficienti është 4 (katër), kurse shuma e fituar është **4.00 Euro**.

4. Për katër numra të përzgjedhur, koeficienti fitues është si vijon:

- Për katër numra të qëlluar koeficienti është 20 (njëzet), kurse shuma e fituar është **20.00 Euro**,
- Për tre numra të qëlluar koeficienti është 6 (gjashtë), kurse shuma e fituar është **6.00 Euro**,
- Për dy numra të qëlluar koeficienti është 2 (dy), kurse shuma e fituar është **2.00 Euro**.

5. Për pesë numra të përzgjedhur, koeficienti fitues është si vijon:

- Për pesë numra të qëlluar koeficienti është 100 (njëqind), kurse shuma e fituar është **100.00 Euro**,
- Për katër numra të qëlluar koeficienti është 20 (njëzet), kurse shuma e fituar është **20.00 Euro**,
- Për tre numra të qëlluar koeficienti është 5 (pesë), kurse shuma e fituar është **5.00 Euro**.

6. Për gjashtë numra të përzgjedhur, koeficienti fitues është si vijon:

- Për gjashtë numra të qëlluar koeficienti është 150 (njëqind e pesëdhjetë), kurse shuma e fituar është **150.00 Euro**,
- Për pesë numra të qëlluar koeficienti është 30 (tridhjetë), kurse shuma e fituar është **30.00 Euro**,
- Për katër numra të qëlluar koeficienti është 9 (nëntë), kurse shuma e fituar është **9.00 Euro**,
- Për tre numra të qëlluar koeficienti është 3 (tre), kurse shuma e fituar është **3.00 Euro**.

7. Për shtatë numra të përzgjedhur, koeficienti fitues është si vijon:

- Për shtatë numra të qëlluar koeficienti është 500 (pesëqind), kurse shuma e fituar është **500.00 Euro**,
- Për gjashtë numra të qëlluar koeficienti është 50 (pesëdhjetë), kurse shuma e fituar është **50.00 Euro**,
- Për pesë numra të qëlluar koeficienti është 20 (njëzet), kurse shuma e fituar është **20.00 Euro**,
- Për katër numra të qëlluar koeficienti është 4 (katër) kurse shuma e fituar është **4.00 Euro**,
- Për tre numra të qëlluar koeficienti është 2 (dy), kurse shuma e fituar është **2.00 Euro**.

8. Për tetë numra të përzgjedhur, koeficienti fitues është si vijon:

- Për tetë numra të qëlluar koeficienti është 2000 (dymijë), kurse shuma e fituar është **2000.00 Euro**,
- Për shtatë numra të qëlluar koeficienti është 500 (pesëqind), kurse shuma e fituar është **500.00 Euro**,
- Për gjashtë numra të qëlluar koeficienti është 30 (tridhjetë), kurse shuma e fituar është **30.00 Euro**,
- Për pesë numra të qëlluar koeficienti është 10 (dhjetë), kurse shuma e fituar është **10.00 Euro**,
- Për katër numra të qëlluar koeficienti është 5 (pesë), kurse shuma e fituar është **5.00 Euro**.

9. Për nëntë numra të përzgjedhur, koeficienti fitues është si vijon:

- Për nëntë numra të qëlluar koeficienti është 4000 (katërmijë), kurse shuma e fituar është **4000.00 Euro**,
- Për tetë numra të qëlluar koeficienti është 800 (tetëqind), kurse shuma e fituar është **800.00 Euro**,
- Për shtatë numra të qëlluar koeficienti është 100 (njëqind), kurse shuma e fituar është **100.00 Euro**,
- Për gjashtë numra të qëlluar koeficienti është 20 (njëzet), kurse shuma e fituar është **20.00 Euro**,
- Për pesë numra të qëlluar koeficienti është 6 (gjashtë), kurse shuma e fituar është **6.00 Euro**,
- Për katër numra të qëlluar koeficienti është 3 (tre), kurse shuma e fituar është **3.00 Euro**.

10. Për dhjetë numra të përzgjedhur, koeficienti fitues është si vijon:

- Për dhjetë numra të qëlluar koeficienti është 5000 (pesëmijë), kurse shuma e fituar është **5000.00 Euro**,
- Për nëntë numra të qëlluar koeficienti është 1000 (njëmijë), kurse shuma e fituar është **1000.00 Euro**,
- Për tetë numra të qëlluar koeficienti është 300 (treqind), kurse shuma e fituar është **300.00 Euro**,
- Për shtatë numra të qëlluar koeficienti është 30 (tridhjetë), kurse shuma e fituar është **30.00 Euro**,
- Për gjashtë numra të qëlluar koeficienti është 10 (dhjetë), kurse shuma e fituar është **10.00 Euro**,
- Për pesë numra të qëlluar koeficienti është 5 (pesë), kurse shuma e fituar është **5.00 Euro**,
- Për katër numra të qëlluar koeficienti është 2 (dy), kurse shuma e fituar është **2.00 Euro**.

Neni 18

Shuma maksimale e cila mund të fitohet për numrat e zgjedhur në një vërtetim është **5.000,00 Euro**
Fituesi potencial i njërit nga Jack-Potet, lajmrohet në ekranin e TV si dhe në vërtetimin e shtypur, kurse shuma e fitimit nuk është e kufizuar.

Nëse gjatë ushtrimit të lojës Keno bie rrjeti i internetit pasi që lojtari i ka zgjedh numrat, ka bërë pagesën dhe ka marr vërtetimin, atëherë vërtetimi për këtë xhiro është valid, kurse informatat lidhur me rezultatet e lojës për atë xhiro merren në pikën e shitjes ku është bërë pagesa.

9. PËRSHKRIMI I VËRTETIMIT

Neni 19

Gjatë pagesës për Keno, lojtarit i jepet vërtetimi që përmban këto shënime kompjuterike:

- logoja dhe emri i organizatorit,
- emri i lojës dhe numri rendor i xhiros,
- numri operativ i shitësit,
- numri i vërtetimit,
- numrat e luajtur,
- shuma e përgjithshme e pagesës,
- data e pagesës dhe koha e saktë e pagesës,
- numri kontrollues i vërtetimit.

Neni 20

Vërtetimet që nuk i kanë shënimet të përcaktuara në nenin 19 janë të pavlefshme. Pjesëmarrësi i lojës Keno është i obliguar që menjëherë pas pagesës ta verifikojë vërtetimin. Në të kundërtën reklamacioni i mëvonshëm nuk vlen.

10. MËNYRA DHE AFATI I PAGESËS SË FITIMEVE

Mënyra dhe afati i pagesës

Neni 21

Pagesa e fitimeve bëhet në pikën e shitjes ku është luajtur, në afatin kohor prej 48 orë, llogaritur nga koha kur është shtypur vërtetimi.

Neni 22

Gjatë pagesës së fitimeve pjesëmarrësi është i obliguar të dorëzojë vërtetimin e rregullt. Vërtetim i rregullt është ai i cili përmban të gjitha elementet e përshkuara në nenin 19 të këtyre Rregullave.

Tatimi në fitim

Neni 23

Tatimin në fitim në Keno e paguajnë personat që kanë realizuar fitim, vetëm nëse ky detyrim është paraparë me ligj.

Fitimet e papaguara

Neni 24

Nëse fituesi nuk tërheq pagesën e fitimit në afatin e përcaktuar në nenin 22, organizuesi shumë të fitimeve të papaguara do ta destinoj sipas neni 17 pika 3 të Ligjit për lojërat e fatit Nr. 04/L-080.

11. MËNYRA E NJOFTIMIT TË PJESËMARRËSVE NË LOJË ME KËTO RREGULLA

Neni 25

Këto Rregulla shpallen në faqen zyrtare të Lotarisë së Kosovës dhe gjenden në të gjitha pikat e shitjes. Personave të interesuar për pjesëmarrje në lojën Keno organizatori është i obliguar t'u mundësojë njoftimin me këto Rregulla, respektivisht t'ua jap në shikim.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 26

Organizatori është i obliguar t'i ruajë shënimet e vërtetimeve në CD më së paku 90 ditë nga dita e tërheqjes së xhiros përkatëse, me përjashtim në rastet kur është hapur procedura gjyqësore për realizimin e së drejtës nga pjesëmarrja në lojën Keno.

Në këtë rast organizatori është i obliguar që t'i ruajë shënimet e vërtetimeve në CD deri në përfundimin e procedurës gjyqësore.

Neni 27

Për zgjidhjen e kontesteve që dalin nga pjesëmarrja në lojën Keno është kompetente Gjykata Themelore e Prishtinës.

Neni 28

Këto Rregulla hyjnë në fuqi ditën e shpalljes.

Prishtinë, datë 25.02.2015.

Lotaria e Kosovës
Bashkim Sllamniku, Drejtor